

AKT - THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

" DANI " SH.P.K

Ne Shkoder , me \_\_\_\_\_ 1999 ( Nentedhjet e nente ) , une i nenshkruari DILAVER DANI , i biri i HETEMIT , i dtlindjes 24 Dhjetor 1957 , me adrese : L. " Ndoc Mazi " , Rr. " Marin Barleti " , Pallati 168 , Shkoder , me cilesine e ortakut te vetem , me vullnetin tim te lire e te plote , vendosa te krijtoj Shoqerine me pergjegjesi te kufi - zuar me emertimin " DANI " SH.P/K me qender ne Shkoder.

HYRJE -

NENI 1

Ne kuptim te ketij Akti , themelues eshte DILAVER DANI , ortakut i vetem themelues i Shoqerise me Pergjegjesi te kufizuar "DANI" SH.P.K.

NENI 2

Qellimi i ketij Akti themelues eshte krijimi i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar " DANI " SH.P.K , seli ne Shkoder dhe perspektive shtrirje ne te gjitha Shqiperine.

NENI 3

Shoqeria " DANI " SH.P.K eshte person Juridik dhe veprimtaria e saj rregullohet sipas Statutit , Ligjit Nr.7512 date 10.08.1991 , Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 " Mbi Shoqerite Tregtare " , dhe Akte te tjera te legjislacionit Shqiptare ne fuqi.

- O B J E K T I -

NENI 4

Objekti i Shoqerise " DANI " SH.P.K do te jete :

" Marrjen ne ruajtje me Roje Civile te objekteve ne pronesi ose ne perdorim te personave Juridik e Fizik , Shqiptare apo te Huaj si : Banka , Arka kursimi , Magazina te lendeve te para per prodhime Industriale , Bujqesore , Magazina e Lokale Tregtie , Rreparte prodhimi , Zyra e Seli Firmash , Banesa private , kampingje dhe cdo objekt ku ruhen vlera pasurore.

Sigurimin e objekteve ku ruhen vlera pasurore , monetare e materiale stacionare ose ne levizje ne te gjitha llojet e Transportit..

Pranimi i kerkesave per ruajtje me Roje Civile te Objekteve ne pronesi ose ne perdorim te Personave Juridik e Fizik Shqiptare ose te Huaj , ne perputhje me piken 5 ( pese ) te Rregullores 129 date 18.05.1993.

Pranimi i kerkesave nga shtetas Shqiptare dhe perzgjedhja e kandidatave qe kerkojne te ushtrojne profesionin si Roje Civile ne perputhje me Nenin 4 (kater) te Ligjit 7696 date 07.04.1993.

Dergimi per miratim ne Organet e Rendit Publik te kerkesave te shtetasve per dhenien e lejes se Ushtrimit te profesionit privat konform Nenit 3 (tre) dhe 5(pese) te ligjit Nr.7696 date 07.04.1993.

### AFATI I VEPRIMTARISE

#### NENI 5

Shoqeria " DANI " SH.P.K do te filloje aktivitetin e saj nga dita e rregjistrimit ne rregjistrin tregtare prane Gjykates se Rrethit Tira - ne , si dhe pajisjen me lejen e ushtrimit te profesionit nga Zyra e Takteve e Rajonit perkates.

#### NENI 6

Shoqeria " DANI " SH.P.K do te ushtroje aktivitetin e saj per nje periudhe mbi 10-vjet.

#### NENI 7

Kapitali fillestare i Shoqerise " DANI " SH.P.K arrin vleften 100.000 ( njeqind mije ) leke. Ortaku i vetem e disponon kete shume baraz 100% e nenshkrueme dhe e shlyer prej Tij.

### BILANCI , VEPRIMTARIA EKONOMIKE , DETYRIMET

#### NENI 8

Shoqeria mban pergjegjesi per te gjitha detyrimet shteterore , sigurimet shoqerore etj.

#### NENI 9

Ortaku i vetem themelues ose persona te tjere te autorizuar prej Tij kane te drejte qe me nxjerrjen e bilancit ekonomik te perfitojne perqindjen e realizuar nga veprimtaria private.

### JURIDIKSIONI

#### NENI 10

Shoqeria " DANI " SH.P.K e ka qendren e saj ne Shkoder , me adrese L.2 Ndoc Mazi " , Rr."Marin Barleti " Pallati 168.

#### NENI 11

Shoqeria " DANI " SH.P.K mund te ushtroje aktivitetin e saj ne te

gjithë territorin e Shqipërisë.

NENI 12

Te gjitha mosmarreveshjet me persona Juridike e Fizike , vendas apo te huaj si dhe organet shteterore , zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tirane.

THEMELUESI

/ DILAVER HETEM DANI /

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE SHKODER

NR. REP. 681  
NR. KOL. 681

AUTENTIFIKIM NENSHKRIMI

Sot me daten 4 Qershor 1999 (NENTEDHJET E NENTE ) , ne Zyren e Note - rise Shkoder dhe para meje AGROM XHEVDET AKSHIA , Noter , u paraqat personalisht : DILAVER DANI , i biri i HETEMIT , lindur ne Shkoder dhe banues ne Shkoder per identitetin e te cilit u sigurova ne baze te leter - njoftimit te tij personal dhe konstatova se i ka te gjitha aftesite e kerkuara nga Ligji , me kerkesen e tij i vertetova nenshkrimin e mesiperm .....  
U pagua taksa 100. leke .....

N O T E R I

/ AGROM XHEVDET AKSHIA /



S T A T U S I

I

SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

" DANI " SH.P.K

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1

Shoqeria tregtare private " DANI " SH.P.K krijohet nga ortaku i vetem Z. DILAVER HETEM DANI ne baze te kriterëve te percaktuara ne Ligjin 7512 date 10.08.1991 dhe ne Kodin Tregtare te Republikës se Shqiperise.

NENI 2

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne baze te ekonomise se tregut te lire.

NENI 3

Ortaku i vetem themelues ne kete sipermarrje ka derdhur kapitalin e tij vendas me qellime qe te perfitoje te ardhurat qe mund te vijne nga vep - rintaria private e Shoqerise , si dhe te perballoje humbjet deri ne kufi - rin e vleres se kontributit ne kapitalin fillestare.

NENI 4

Shoqeria " DANI " SH.P.K eshte person Juridik dhe fiton zotesine per te vepruar me rregjistrin ne Gjykaten e Rrethit Tirane dhe pajisjes me lejen e ushtrimit te profesionit nga Zyra e Tatimeve e Rajonit perkates.

EMRI - SELIA-TERRITORI

NENI 5

Emertimi i shoqerise do te jete :

Shoqeria Tregtare Private " DANI " SH. P.K

NENI 6

Selia e Shoqerise do te jete ne Shkoder , me adrese L." Ndoc Mazi " , Rr. " Marin Barleti " Pallati 168. Shoqeria me perspektive mund te ushtro - je aktivitetin e saj ne te gjithe Shqiperine.

NENI 7

Aktiviteti privat i Shoqerise do te zhvillohet me nje kohe zgjatje prej me shume se 10 - vjet. " - - - - -

O B J E K T I

NENI 8

Objekti i Shoqerise " DANI " SH.P.K do te jete :

" Marrjen ne ruajtje me Roje Civile te objekteve ne pronesi ose ne per -

dorim te personave Juridik e Fizik , Shqiptare ose te Huaj si :  
Banka , Arka kursimi , Magazina te lendeve te para per prodhime Industri -  
ale e Bujqesore , Magazina e Lokale Tregtije , Reparte prodhimi , Zyra  
e Seli Firmash , Kampingje , Banesa private dhe cdo objekt ku ruhen  
vlera pasurore.

Sigurimin e objekteve ku ruhen vlera pasurore , monetare e materiale  
Stacionare ose ne levizje ne te gjitha llojet e Transportit. Pranimi i  
kerkesave per ruajtjen me Roje Civile te objekteve ne pronesi ose ne  
perdorim te personave Juridik e Fizik Shqiptare ose te Huaj ne perputhje  
me piken 5 (pese) te rregullores 129 date 18.05.1993.

Pranimi i kerkesave nga shtetas shqiptare dhe perzgjedhja e kandidate -  
ve qe kerkojne te ushtrojne profesionin si Roje Civile ne perputhje me  
Nenin 4 (kater) te Ligjit Nr.7696 date 07.04.1993.

Dergimi per miratim ne Organet e Rendit Publik te kerkesave te shtetas -  
ve per dhenjen e lejes se ushtrimit te profesionit privat konform Neni  
3 (tre) dhe 5(pese) te Ligjit 7696 date 07.04.1993.

#### NENI 9

#### KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali fillestare i shoqerise private " DANI " SH.P.K arrin vleften  
100.000 (njqind mije ) leke. Ortaku i vetem Z.DILAVER DANI e disponon  
kete shume baraz 100% e nenshkrueme dhe shlyeme prej Tij.

#### NENI 10

Kapitali themeltar mund te rritet me shtimin e aktivitetit te Shoqerise.  
Zvogelimi i Kapitalit Themeltar nen vleften 100.000 leke e detyron Sho -  
qerine te shnderrohet ne nje forme tjeter , ne rast se ajo nuk merr ven -  
dim per rritjen e kapitalit deri ne vleften e mesiperme.

#### NENI 11

Me pelqimin e ortakut te vetem themelues pjese te kapitalit mund te  
transferohet ne rruge trashigimie ose personave te tjere qe nuk bejne  
pjese ne shoqeri.

#### NENI 12

Ne rast te shtimit te ortakeve pjese te kapitalit mund te transferohen  
me pelqimin e tyre ( te shumices ) ne rast se ata perfaqesojne 3/4 e  
kapitalit themeltare. Transferimet do te vertetohen me Akt Noterial.

#### NENI 13

Ne rast vdekjeje te njerit prej ortakëve , trashigimtaret e Ligjshem mund te marrin pjese ne Shoqerine " DANI " SH.P.K . Kur trashigimtaret e Ligjshem refuzojne te marrin pjese ateher Shoqeria ka te drejte te vazhdoje ekzistencen e saj edhe me nje ortak te vetem i cili kerkon modi - fikimin e nevojshme ne Statusin e Shoqerise.

#### DREJTIMI ADMINISTRATIV

##### NENI 14

Shoqeria Tregtare Private " DANI " SH.P.K do te kete si administrator ortakun e vetem themelues Z. DILAVER DANI . Themeluesi i Shoqerise ka ne kopetence te caktoje administrator edhe persona te tjere , te cilet nuk kane cilesine e ortakut.

##### NENI 15

Administratori ka te drejte dhe per detyre organizimin dhe drejtimin e veprimtarise se Shoqerise. Ai mund te kryeje te gjitha veprimet e administrimit ne interes te Shoqerise.

##### NENI 16

Ne marredheniet me te tretet administratori e angazhon Shoqerine neper - mjet Akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj.

##### NENI 17

Ortaku i vetem ka kopetence :

- Te miratoje programin e Shoqerise , te hartojte raportin e administrimit , inventaret dhe llogarite vjetore.
- Vendos per shperberjen e Shoqerise.
- Vendos per ndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve.
- Rregullon marredheniet e punesimit dhe te shperblimit brenda Shoqerise.
- Sipas Akteve Ligjore ben shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve shtetere e personave Juridik Vendas apo te Huaj.

##### NENI 18

Administratori ka te drejte te informohet per veprimtarine e Shoqerise si dhe te njihet me dokumentat e saj dhe llogarite perkatese ne rast se kete mbahen nga persona te tjere ta caktuar prej tij.

##### NENI 19

Administratori e humbet detyren e tij ne rast te prishjes se Shoqerise dhe kur eshte zgjedhur shkarkohet nga ortaku themelues.



- MARREDHENIET FINANCIARE -

NENI 20

Shoqeria Tregtare Private " DANI " SH.P.K mund te lidhe kontrata me sektore shteterore , drejtperdrejte me tregun e lire , si dhe me persona juridike e fizik vendas e te huaj.

NENI 21

Ne veprimet kontraktuale Shoqeria perfaqesohet nga administratori i saj Z. DILAVER DANI ose nga persona te tjere te caktuar prej tij. Te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga kontratat jane te detyrueshme per shoqerine.

NENI 22

Shoqeria pergjigjet per kontributin fiskal , afatet e derdhjes se tij , Sigurimet Shoqerore etj. Ajo ka te drejte te cele llogari likuiduese pra - ne Bankave te vendit dhe te kryeje veprimet likuiduese nepermjet tyre.

NENI 23

Per sigurimin e veprimtarise ekonomike Shoqeria ka te drejte te vetefinancohet ne leke ose valute te huaj. Shkembimin e monedhes shqiptare ne monedhe te huaj dhe anasjelltas mund ta beje ne perputhje me kursin e caktuar nga Banka e Shtetit Shqiptare ose ne tregun privat te valutes.

NENI 24

Per pasqyrimin e aktivitetit privat , Administratori ose persona te tjere te caktuar prej tij jane te detyruar te mbajne dokumentacion te rregullt financiar ne rregjistrat perkates sipas ligjit te vecante.

NENI 25

Veprimtaria ekonomike e Shoqerise mbaron ne Muajin Dhjetor te cdo Viti. Administratori ose persona te tjere te caktuar prej tij jane te detyruar te paraqesin bilancin vjetor dhe deklaraten e te ardhurave dhe ti depozitojne ne organin financiar te juridiksionit perkates.

.- K R E U III

NENI 26

Ortaku themelues vendos per shtimin ose pakesimin e numrit te ortakëve dhe personave te tjere te punesuar ne veprimtarine e Shoqerise private....

" DANI " SH.P.K.

NENI 27

Marredheniet e punesimit brenda Shoqerise rregullohen sipas kontrates se punes qe lidhet midis paleve ne perputhje me legjislacionin Shqiptare.

NENI 28

Marrja ne pune behet me rregjistrimin ne librin e punes se Shoqerise , nga punedhenesi si dhe duke njoftuar organet e punes te juriksionit ku ushtron aktivitetin Shoqeria.

NENI 29

Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punes behet ne baze te nje Akti me shkrim leshuar nga ortakut i vetem themelues. Largimi lidhet me mbarimin e kontrates se punes , per shkak te shkeljeve disiplinore ose me vete kerkesen e te interesuarit.

NENI 30

Largimi nga Shoqeria behet pasi jane shlyer detyrimet materiale dhe monetare.

E L E M E N T E T E T J E R A

NENI 31

Shoqeria mund te marre truall per ndertim ose me qira dhe objekte te ndryshme ne pronesi sipas nje kontrate te vecante. Dhenia dhe vlefta perkatese e tyre percaktohen nga organi financiare ne juridiksionin e te cilit ndodhet trualli ose objekti.

- B I L A N C I D H E T E A R D H U R A T -

NENI 32

Pas shlyerjes se detyrimeve fiskale , detyrimeve te tjera ndaj Shtetit , Sigurimeve Shoqerore etj te ardhurat kalojne ne pronesi te ortakut te vetem ose te ortakeve kur keto jane me shume se nje.

- H U M B J A E T E D R E J T E S S E O R T A K E R I S E

NENI 33

Ortakut e humbet te drejten e ortakesrise kur :

- Kur kerkon vaxte vete largimin e tij nga Shoqeria " DANI " SH.P.K.
- Kur perjashtohet me vendim te ortakut te vetem themelues ose me shumice 2/3 te ortakeve te Shoqerive.

- P E R G J E G J E S I T E - L I G J O R E -

NENI 34

Ortakut themelues per pergjegjes individualisht ose solidarisht sipas rasis ndaj Shoqerise " DANI " SH.P.K ose te treteve per shkelje te ligjeve , per shkelje te statutit apo per faje te kryera gjate administrimit te Shoqerise " DANI " SH.P.k.

- Z G J I D H J A E M O S M A R R E V E S H J E V E +

NENI 35



Mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se Shoqerise " DANI " SH.P.K do te zgjidhen me mirekuptim te paleve te cilat per kete qellim mund te caktojne nga nje perfaqesues me prokure. Kur mirekupti - mi eshte i mundur , palet i drejtohen Gjykates se Tiranes.

- M B Y L L J A E S H O Q E R I S E -

NENI 36

Veprimtaria e Shoqerise " DANI " SH.P.K mbaron me 31 Dhjetor 2009 , ose me pare sipas vendimit te marre nga ortakut themelues. Shoqeria shperndahet ne forme riorganizimi ose likuidimi.

NENI 37

Kur Shoqeria likuidohet : Ortaku themelues emeron komisionin e likuidimit te cilit i paraqet bilancin e likuidimit dhe Shoqeria i jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te ketij bilanci. Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se Shoqates dhe fondet financiare i kalojne ortakut theme - lues ose ne rast te shtimit te ortakeve ndahen ndermjet paleve ne per - pjestim me kuotat e vena pasi te jene bere pagesat per kreditorët.

NENI 38

Kryetari dhe anetaret e Komisionit te revizionimit kontabel nuk duhet te jene ne varesi te Shoqerise " DANI " SH.P.K , ne vecanti , dhe legj - islacionit Shqiptare ne pergjithesi.

Statusi eshte hartuar me vullnet te lire te ortakut te vetem themelues dhe eshte firmosur nga ana e tij.

ORTAKU THEMELUES  
/ DILAVER HETEM DANI /

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE SHKODER

NR. VP. 69/2  
NR. KOL. 69/2

AUTENTIFIKIM NENSHKRIMI

Sot me daten 4 Qershor 1999 ,ne Zyren e Noterise , Shkoder , dhe para meje AGRON XHEVDET AKSHIA , Noter , u paraqet personalisht .....

DILAVER DANI , i biri i HETEMIT , lindur ne Shkoder dhe banues ne  
Shkoder , L." Ndoc Mazi " , Rr." Marin Barleti " , Ballati 168 dhe i  
dtlindjes ..... 24 Dhjetor 1957 , per identitetin e te cilit u  
sigurova ne baze te leternjoftimit te tij personal dhe si konstatova  
se i ka te gjitha aftesite e kerkuara nga Ligji , me kerkese te tij i  
vertetova nenshkrimin e mesiperm.  
U pagua taksa 100. leke .....

NOTERI  
AGRON XHEVDET AKSHIA /





3

**AKT THEMELUES**  
**SHOQERISE SE RUAJTJES DHE TE SIGURISE FIZIKE**  
**"DANI Security" Sh.p.k**

Sot me daten .2001, ne Tirane, Shqiperi:

- Une, i nenshkruari Dilaver DANI , i biri i Hetemit dhe i Ashimese lindur ne Shkoder me 24.12.1957, banues ne Shkoder , Rr."Fahri Ramadani ", Lagja Partizani Nr 1243, me leternjoftmi UG NR 145600,mbeshtetur ne Ligjen Nr.7512 date 10.8.1991, ligjen 7638 date 19.11.1992, Ligjen N.8770 date 19/04/2001 "Per Sherbimin e Ruajtjes dhe te Sigurise Fizike", si dhe ne Legjislacionin Shqiptar ne pergjithesi, me cilesine e Ortakut te vetem Themelues, kam vendosur per sa me poshte vijon:

Neni 1

Abrogohet Akti i themelimit i dates 09.06.1999

Neni 2

Themelohet nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, per te zhvilluar veprimtari ne perputhje me Ligjin N.8770 date 19/04/2001, qe ka te beje me:

- sigurimin e objekteve publike e private ne pronesi ose ne perdorim te personave fizike e juridike qe ushtrojne veprimtari ne Republiken e Shqiperise.
- sigurimin dhe mbrojtjen e jetes dhe te shendetit te personave fizike, shtetas shqiptare ose/dhe te huaj.

Neni 3

Shoqeria emertohet: Shoqeria e Ruajtjes dhe e Sigurise Fizike ""DANI Security" Sh.p.k

Neni 4

Shoqeria ka seline ligjore ne Shkoder ne adresen: Rr."31 Dhjetori ", prane FEFAD - BANK

Ne baze te nenit 5, pika 2 e Ligjit N.8770 date 19/04/2001 "Per Sherbimin e Ruajtjes dhe te Sigurise Fizike", Shoqeria ka te drejte te ushtroje veprimtarine ne te gjithe teritorin e R.Shqiperise.

#### Neni 5

Objekti i shoqerise do te jete kryerja e sherbimeve te kategorive (a+b):

- Ruajtja dhe Sigurimi i objekteve publike e private ne pronesi ose ne perdorim te personave fizike e juridike, qe ushtrojne veprimtari ne Republiken e Shqiperise.
- Sigurimi dhe mbrojtja e jetes dhe e shendetit te shtetasve vendas dhe te huaj.

Shoqeria per te permbushur misionin e vet, ka te drejte te vendose mjete ose sisteme vrojtuese, sinjalizuese, audiovizive, pajisje nderlidhjeje, si dhe te perdore teknika te tjera, duke respektuar legjislacionin ne fuqi. Per ruajtjen a objekteve, shoqeria mund te perdore edhe qen sherbimi, duke marre masat perkatese per parandalimin e pasojave qe mund te sjelle ky lloj sherbimi.

#### Neni 6

Kohezgjatja e Shoqerise eshte fiksuar deri me 31 Dhjetor 2011 dhe mund te zgjatet ose te priset me perpara me vendim te Ortakut i Vetem Themelues.

#### Neni 7


Kapitali themeltar i Shoqerise, eshte percaktuar ne 4.000.000 (kater milion) Leke.

Ky kapital eshte nenshkruar dhe shlyer si me poshte:

- 4.000.000 (kater milion) leke, ne emer te Dilaver Dani , baras me 100% te kapitalit te Shoqerise.

#### Neni 8

Viti financiar do te mbyllet me 31 dhjetor te çdo viti kalendarik. Ortaku i Vetem Themelues kujdeset qe brenda kufijve dhe ne zbatim te normave



ligjore te hartoje inventarin dhe bilancin te perbere nga gjendja pasurore, llogaria ekonomike dhe nga llogarite plotesuese duke i shoqeruar ato me nje relacion mbi ecurinee administrimit te Shoqerise.

Mbi te ardhurat neto qe rezultojne nga bilanci i vitit financiar do te zbritet nje kuote jo me pak se 5% per t'u shenuar si rezerve ligjore.

#### Neni 9

Administrimi i Shoqerise, dhe perfaqesimi ligjor i saj i besohet Ortakut te Vetem Themelues Z.Dilaver Dani .

Drejtimi Teknik i Shoqerise i besohet Z. Astrit DEMOLLARI , i cili eshte pergjegjes ligjor per drejtimin, bashkerendimin dhe kontrollin e sherbimit te ruajtjes dhe te sigurise fizike.


Qysh nga ky çast vendoset qe te gjitha derdhjet e kapitalit te kryhen ne monedhe te vendit ashtu dhe fitimet dhe financimet eventuale te ardhshme nga ortaku i vetem themelues ose nga te tretet si dhe te gjitha arketimet qe kane te bejne me shitjen e Shoqerise, duhet te derdhen ne nje llogari qe do te hapet prane nje Banke *me: Republiken e Shqipetris*

#### Neni 10

Ky Akt u hartua ne kater kopje identike e me te njeten vlere.

ORTAKU THEMELUES

Dilaver DANI



*Dilaver Dani*



# STATUTI

i

## SHOQERISE SE RUAJTJES DHE TE SIGURISE FIZIKE

"DANI Security" Sh.p.k

### DISPOZITA TE PERGJITHSHME

#### Neni 1

Abrogohet Statuti i mepareshem i dates 09.06.1999

#### Neni 2

Shoqeria e Ruajtjes dhe e Sigurise Fizike "DANI Security" Shpk krijohet nga ortaku themelues *Dilaver Dani*, ne baze te kriterëve te percaktuara ne Ligjin 7512 date 10.08.1991, Ligjin 7638 date 19.11.1992, Ligji N.7667 date 28.01.1993, Kodin Tregtar te Republikës se Shqiperise dhe ne veçanti Ligjin N.8770 date 19/04/2001 "Per Sherbimin e Ruajtjes dhe te Sigurise Fizike".

#### Neni 3

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne baze te ekonomise te tregut te lire.

#### Neni 4

Ortaku themelues ne kete Siper marrje ka derdhur kapitalin e tij vendas, me qellim qe te perfitoje te ardhurat qe mund te vijne nga veprimtaria private e Shoqerise, si dhe te perballojne humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit ne Kapitalin themeltar.

#### Neni 5

Shoqeria e Ruajtjes dhe e Sigurise Fizike "DANI Security" Shpk eshte person juridik dhe fiton zotesine per te vepruar me rregjistrimin ne Gjykatën e Rrethit Tirane dhe paisjes me lejen e ushtrimit te profesionit nga Zyra e Tatimeve e Rajonit perkates.

### EMRI, SELIA, TERRITORI

#### Neni 6

Emertimi i Shoqerise do te jete : *Shoqeria e Ruajtjes dhe e Sigurise Fizike "DANI Security" Shpk*

#### Neni 7

Selia e Shoqerise do te jete ne Shkoder, ne adresen: Rr."31 Dhjetori", prane FEFAD - Bank



Ne baze te nenit 5, pika 2 e Ligjit N.8770 date 19/04/2001 "Per Sherbimin e Ruajtjes dhe te Sigurise Fizike", Shoqeria ka te drejte te ushtroje veprimtarine ne te gjithë teritorin e R.Shqiperise.

#### Neni 8

Aktiviteti privat i Shoqerise do te zhvillohet me nje kohezgjatje prej me shume se 10 vjet duke filluar nga data e fitimit te zotesise juridike te saje.

#### Objekti

#### Neni 9

Objekti i shoqerise eshte kryerja e sherbimeve te kategorive (a+b):

- Ruajtja dhe Sigurimi i objekteve publike e private ne pronesi ose ne perdorim te personave fizike e juridike, qe ushtrojne veprimtari ne Republiken e Shqiperise.

- Sigurimi dhe mbrojtja e jetes dhe e shendetit te shtetasve vendas dhe te huaj. Shoqeria per te permbushur misionin e vet, ka te drejte te vendose mjete ose sisteme vrojtuese, sinjalizuese, audiovizive, pajisje nderlidhjeje, si dhe te perdore teknika te tjera, duke respektuar legjislacionin ne fuqi. Per ruajtjen a objekteve, shoqeria mund te perdore edhe qen sherbimi, duke marre masat perkatese per parandalimin e pasojave qe mund te sjelle ky lloj sherbimi.

### KAPITALI I SHOQERISE

#### Neni 10

Kapitali themeltar i Shoqerise se Ruajtjes dhe te Sigurise Fizike "DANI SECURITY" Shpk, arrin vleften 4.000.000(kater milion) leke. Kapitali i mesiperm eshte nenshkruar dhe shlyer ne masen 100% nga Ortaku Themelues Dilaver Dani .

#### Neni 11


Kapitali themeltar mund te rritet me shtimin e aktivitetit te Shoqerise. Zvogelimi i Kapitalit Themeltar nen vleften 4.000.000(kater milion) leke e detyron Shoqerine te kufizohet per te kryer aktivitet:

- Vetem te kategorise "b" ne se kapitali Themeltar eshte ndermjet 3.000.000(tre milion) leke e 4.000.000(kater milion) leke;
- Vetem te kategorise "a" ne se kapitali Themeltar eshte ndermjet 2.000.000(dy milion) leke e 3.000.000(tre milion) leke;

ne rast se ajo nuk merr vendim per rritjen e Kapitalit deri ne vleften 4.000.000(kater milion) leke.

#### Neni 12

Pjese ose i gjithe i kapitali mund te transferohen me pelqimin e Ortakut Themelues. Transferimet e Kapitalit do te vertetohen me akt Noterial.



### Neni 13

Ne rast vdekjeje te Ortakut Themelues, trashegimtaret e ligjshem mund te marrin pjese ne Shoqerine e Ruajtjes dhe e Sigurise Fizike "DANI SECURITY" ShPK. Kur trashegimtaret e ligjshem refuzojne te marrin pjese, atehere Shoqeria i nenshtrohet likujdimit.

## DREJTIMI ADMINISTRATIV

### Neni 14

Shoqeria e Ruajtjes dhe e Sigurise Fizike "DANI SECURITY" ShPK do te kete si Administrator Ortakun Themelues Z.Dilaver Dani.

### Neni 15

Administratori ka per detyre te kryeje te gjitha veprimet e administrimit ne interes te Shoqerise.

### Neni 16

Administratori ka keto kompetenca:

- Harton raportin e administrimit, inventaret dhe llogarite vjetore.
- Rregullon marredheniet e punesimit dhe te shperblimit brenda Shoqerise.
- Sipas akteve Ligjore ben shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve Shteterore, personave Juridike ose Fizike vendas ose te huaj.

### Neni 17

Administratori ka te drejte te informohet per veprimtarine e Shoqerise, si dhe te njihet me dokumentat e saj dhe llogarite perkatese ne rast se keto mbahen nga persona te tjere te caktuar prej tij.

### Neni 18

Administratori e humbet detyren e tij ne rast te prishjes se Shoqerise dhe, kur eshte i zgjedhur, kur shkarkohet nga Ortaku i Vetem Themelues.

## DREJTIMI TEKNIK

### Drejtuesi teknik

### Neni 19

Shoqeria ka ne perberje te personelit te ruajtjes dhe te sigurise fizike nje Drejtues teknik, i cili pajiset me lejen perkatese per ushtrimin a profesionit kur ploteson kushtet e parashikuara ne Ligjin N.8770 date 19/04/2001 "Per Sherbimin e Ruajtjes dhe te Sigurise Fizike".



## Neni 20

Drejtuesi Teknik eshte drejtuesi me i larte teknik i Shoqerise dhe pergjegjes ligjor per trajtimin, bashkerendimin dhe kontrollin e sherbimit te ruajtjes dhe te sigurise fizike.

Kur per shkaqe te ndryshme Drejtuesi Teknik largohet nga shoqeria, kjo eshte e detyruar te njoftoje menjehere Drejtorin e policise se qarkut, ku ushtron veprimtarine. Ne keto raste Shoqeria brenda 45 diteve i paraqet autoritetit licencues kerkesen per zevendesimin e drejtuesit teknik, si dhe per paisjen e tij me lejen perkatese, nese ai nuk ka nje te tille.

## Neni 21

Drejtuesi teknik i shoqerise eshte i detyruar te njoftoje menjehere organin e Policise se Shtetit per cdo ngjarje qe ndodh ne objektet qe ka ne ruajtje shoqeria dhe cdo tre muaj njofton me shkrim per kryerjen e detyrave te ruajtjes dhe te sigurise fizike, si dhe per problemet qe kane lindur.

## Neni 22

Shoqeria "DANI SECURITY" Shpk do te kete si Drejtues Teknik, Z.Astrit DEMOLLARI.

## Neni 23

Marredheniet ndermjet Shoqerise dhe personit fizik a juridik qe merret ne ruajtje regullohen me marreveshje te perbashket, ku pjese e saj eshte dhe Rregullorja e Sherbimit dhe sipas rastit rregullorja a brendeshme e objektit. Drejtuesi Teknik nenshkruan marreveshjet me persona te autorizuar nga personi fizik a juridik qe merret ne ruajtje. Ne marreveshjen e nenshkruar nga palet Rregullorja e Sherbimit, eshte pjese e marreveshjes dhe hartohet sipas rregullores tip te miratuar me urdher te Ministrit te Rendit Publik.


## Punonjesi i sherbimit

### Neni 24

Shoqeria ka ne perberje te personelit te ruajtjes dhe te sigurise fizike nje **Punonjes te Sherbimit**, i cili pajiset me lejen perkatese per ushtrimin a profesionit kur ploteson kushtet e parashikuara ne Ligjin N.8770 date 19/04/2001 "Per Sherbimin e Ruajtjes dhe te Sigurise Fizike".

### Neni 25

Punonjesi i sherbimit vepron me cilesine a rojes, te truprojes, te operatorit dhe kryen detyra te ngjashme me to si dhe permbush detyrat e ruajtjes dhe te sigurise fizike, te percaktuara ne Ligjin N.8770 date 19/04/2001 "Per Sherbimin e Ruajtjes dhe te Sigurise Fizike".



Punonjesi i Sherbimit ka pergjegjesi ligjore per ruajtjen e objektit .

## K R E U II

### MARREDHENIET FINANCIARE

#### Neni 26

Shoqeria e Ruajtjes dhe e Sigurise Fizike "DANI SECURITY" Shpk, mund te lidhe Kontrata me sektore Shteterore, drejtperdrejte ne tregun e lire, si dhe me Persona Juridike e Fizike vendas a te huaj.

#### Neni 27

Ne veprimet Kontraktuale Shoqeria perfaqesohet nga Drejtues Teknik i saj Z. Astrit DEMOLLARI. Te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga kontratat jane te detyrueshme per Shoqerine.

#### Neni 28

Shoqeria pergjigjet per kontributin fiskal, afatet e derdhjes se tij, sigurimet shoqerore, etj. Ajo ka te drejte te çele llogari likuiduese prane Bankave te vendit dhe te kryeje veprimet likuiduese nepermjet tyre.

#### Neni 29


Per sigurimin e veprimtarise ekonomike Shoqeria ka te drejte te vetfinancohet ne Leke ose ne valute te huaj. Shkembimin e monedhes shqiptare ne monedhe te huaj dhe anasjelltas mund ta beje ne perputhje me kursin e caktuar nga Banka e Shtetit Shqiptar ose ne tregun e lire privat te valutes.

#### Neni 30

Per pasqyrimin e aktivitetit, *Administratori* ose persona te tjere te caktuar prej tij, jane te detyruar te mbajne dokumentacion te rregullt financiar dhe rregjistrat perkates sipas Ligjit te vecante.

#### Neni 31

Veprimtaria ekonomike e Shoqerise mbaron ne muajin Dhjetor te çdo viti. *Administratori* ose personat e caktuar prej tij jane te detyruar te paraqesin bilanc vjetor dhe deklaraten e te ardhurave dhe t'i depozitojne ne organin financiar te juridiksionit perkates.



## K R E U III MARREDHENIET E PUNESIMIT

### Neni 32

Ortaku themelues vendos per shtimin ose pakesimin e numrit te ortakeve dhe personave te tjere te punesuar ne veprimtarine e Shoqerise "DANI SECURITY " Shpk.

### Neni 33

Maredheniet e punesimit brenda Shoqerise rregullohen sipas kontrates se punes qe lidhet midis paleve, ne perputhje me Legjislacionin shqiptar.

### Neni 34

Marrja ne pune behet me rregjistrimin nga punedhenesi ne Librin e Punes se Shoqerise, si dhe duke njoftuar organet e Punes te juridiksionit ku ushtron aktivitetin Shoqeria.

### Neni 35

Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punes behet ne baze te nje akti me shkrim te leshuar nga *Administratori*. Largimi lidhet me mbarimin e Kontrates se Punes, per shkak te shkeljeve disiplinore, ose me vete kerkesen e te interesuarit. Mosmarreshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se Shoqerise "DANI SECURITY" Shpk, do te zgjidhen me mirekuptim te paleve, te cilat per kete qellim mund te caktojne nga nje perfaqesues me prokure. Kur mirekuptimi s'eshte i mundur, palet i drejtohen Gjykates se Tiranes .


## MBYLLJA E SHOQERISE

### Neni 36

Veprimtaria e Shoqerise "DANI SECURITY" Shpk, mbaron me 31.12.2011, ose me pare sipas vendimit te marre nga Ortaku i Vetem Themelues. Shoqeria shperndahet ne forme riorganizimi ose likujdimi. Nese ne cfardo lloj kohe dhe per cfardo lloj arsyeje vendoset prishja e shoqerise, Ortaku i Vetem Themelues percakton modalitetet e likujdimit dhe emeron nje ose disa likujdatore duke ju percaktuar dhe detyrat.

### Neni 37

Kur Shoqeria "DANI SECURITY " Shpk likujdohet Ortaku i Vetem Themelues emeron komisionin e likujdimit, ose nje likuidator i cili paraqet bilancin e likujdimit dhe Shoqeria i jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te ketij bilanci. Mjetet financiare, te fituara si rezultat i veprimtarise se Shoqerise dhe fondet



financiare i kalojne Ortaku te Vetem Themelues, pasi te jene bere pagesat per kreditoret.

### Neni 38

Kryetari dhe anetaret e Komisionit te revizionit kontabel, nuk duhet te jene ne vartesi te "DANI SECURITY" SHPK. Komisioni i revizionit kontabel eshte pergjegjes per veprimtarine e vet.

## DISPOZITAT E FUNDIT

### Neni 39

Persa nuk eshte shprehur ne statut, gjithçka i referohet Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992, "Per Shoqerite Tregtare", ne veçanti Ligjit N.8770 date 19/04/2001 "Per Sherbimin e Ruajtjes dhe te Sigurise Fizike" si dhe Legjislacionit Shqiptar ne pergjithesi.

Statuti eshte hartuar me vullnetin tim dhe eshte firmosur prej meje

ORTAKU THEMELUES

*Dilaver Dani*



REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA - TIRANE

NR. 6826 REP

NR. 339 KOL

### VERTETIM

Sot me daten 6/10/2001 (dymije e nje), ne Tirane, ne Zyren e Noterise Tirane, u paraqit para meje Noteres: **Dilaver Dani**, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit un Noterja jam e sigurte nga verifikimi i Dokumentit te tij te identitetit, Leternjoftimi UG Nr.145600.

Ai deklaroi se **Statuti** i mesiperm, i redaktuar jashte kesaj zyre, eshte sipas vullnetit te tij te lire e te plote dhe e nenshkroi ate rregullisht. Une Noterja e gjej kete veprim ne perputhje me Ligjen, e firmos rregullisht sipas Ligjes Mbi Noterine N.7829, date 1/06/1994, Neni 39, germa c.

